

## **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

#### **OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**Blerje asfalto-beton, viti 2026**

#### **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**44113620-7**

**VLERA E FONDIT LIMIT: - 45.832.785** (dyzet e pese million e teteqind e tridhjetë e dymije e shateqind e tetedhjetë e pese) **leke pa TVSH**

**-Valuta e huaj- 475543** (katerqind e shtatedhje e pesemije e peseqind e dyzet e tre) **Euro.**

**Banka Shqipersise (kursi kembimit)** Bank of Albania, Exchange rate 1 euro=96.38 exchange rate date 19.02.2026

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja Rruga Durres ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Për përlogaritjen e fondit limit grupi punës u mbështet në VKM 285 date **19.5.2021** **“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”** neni 76 mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit

1. Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:
  - a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
  - b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
  - c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;

ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

U përzgjedh kjo metodologji sipas gërmes a pasi në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor sipas çmimeve e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manualeçmimet e atikujve mund të kenë pësuar ndryshime. Cmimi për njësi të asfaltit do të përcaktohet nga manuali sipas **PORTALIT ealbania vkm 216, datë 13.04.2023**. Kërkohet me transportin që do të kryhet nga mjetet e OE, kjo për arsye të përfitimit sa më të madh duke ulur kostot e transportit dhe të organizimit sa më efikas të detyres.

Gjithashtu dhe transporti u përlllogarit në cmimet e **PORTALIT ealbania , vkm 216, datë 13.04.2023**.

Për kërkesën e cila lidhet për sa më sipër bëjmë me dije që kjo kërkesë lidhet me:

1. Përfitimin e një cmimi sa më konkurrues në treg, dhe duke plotësuar kushtin e mësipërm OE ofertues detyrimisht që në drejtorinë e tatimeve përkatëse duhet të ketë të depozituar një bilanc shumë konkret në lidhje me ofertën e cmimit të asfaltit.
2. Në vijim të kërkesës tonë për uljen e kostove akoma më tepër për buxhetin e bashkisë Durrës, është kërkuar edhe transporti i materialit nga OE. Për këtë qëllim nuk ulen vetëm kostot e transportit por edhe shpenzime të tjera operative si konsum mjetesh apo gjera të ngjashme.

Gjithashtu dhe transporti u përlllogarit në cmimet e manualit.

Në tabelën e preventivit është reflektuar përlllogaritja e sasisë dhe cmimit.

**U krye përlllogaritja e preventivit sipas çmimeve të PORTALIT ealbania, vkm 216, datë 13.04.2023.**

Për asfaltin e ftohtë, ofertat e tregut, pasi në manualin e çmimeve nuk ekziston ky produkt dhe ofertat janë marrë: me nr.85/1 prot më datë 16.02.2026 dhe me nr.85/2 prot date.17.02.2026. Për sa më sipër u realizua mesataria e tre ofertave dhe na rezulton që për 1 (një) Ton asfalt i ftohet cmimi është 62.000 lek pa t.v.sh.

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4**;

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës/ lotit” bazuar në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomikofinanciare” pika 2/a dhe nenin 47 “Procedura e hapur” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit të kontratës/lotit që prokurohet është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomikofinanciare” pika 2/a

të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Në rastin konkret nga ana e Njësisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Duke patur parasysh, përcaktimin e bërë në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 2/a, AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së kontrates në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontrates për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, **për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;** si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:

Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme**, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. E cila është një vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, që është realizuar **gjatë tri viteve të fundit** nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

**Per kete pikë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtme:**

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës**, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/ dhe fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat**, si dëshmi pranohen **vetëm fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e

mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

---

**2.3.2 Mbështetur në VKM nr.628 datë 15.7.2015 “Për miratimin e rregullave teknike dhe ndërtimit të rrugëve”, për asfaltobeton (tapet) dhe për asfalto-beton (binder) Raport Testimeve dhe Recetat perkatese, për sa më sipër.** Sipas kartes teknologjike, për prodhim asfaltobetonit dhe raportin përkatës sipas Neni 43 pika 2 të VKM Nr.612 , date 05.09.2012 për dispozitat zbatuese të Ligjit “ Per akcizat” , kjo sipas VKM Nr 434 , datë 20.05.2015 “ Për Përcaktimin E Normativave Për Firot, Humbjet, Dëmtimet Dhe Skarcot Gjatë Prodhimit , Magazinimit, Transportimit etj . Të Njohura Për Qëllime Fiskale“ pika 1 ; 7; 8. **Kerkohej Karta Teknologjike.**

**Argumentimi:**Ky kriter u vendos në përputhje me, neni 77, pika 4, ligji nr.162, date 23.12.2021 pasi bëri mund të mundur dhe garanton, përputhshmerine dhe rregullsine e procesit të furnizimit, cilesine e produktit si dhe disponibilitetin të mallit me cilesine e kërkuar, përputhshmerine të kontratës. Aftësia e operatorëve ekonomikë për të ofruar mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative dhe besueshmërinë për të zbatuar kontratën. neni 77, pika 4, ligji nr.162, date 23.12.2021 si dhe VKM nr.628 datë 15.7.2015 “Për miratimin e rregullave teknike dhe ndërtimit të rrugëve” mbështetur sipas kartes teknologjike, për prodhim asfaltobetonit dhe raportin përkatës sipas Neni 43 pika 2 të VKM Nr.612 , date 05.09.2012 për dispozitat zbatuese të Ligjit “ Per akcizat” , kjo sipas VKM Nr 434 , datë 20.05.2015 “ Për Përcaktimin E Normativave Për Firot, Humbjet, Dëmtimet Dhe Skarcot Gjatë Prodhimit , Magazinimit, Transportimit etj . Të Njohura Për Qëllime Fiskale“ pika 1 ; 7; 8.

**2.3.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të provojnë se janë në gjendje apo kanë të garantuar furnizimin e produkteve të asfaltit, për sa më sipër duhet të paraqesë dokumentacionin për: **Fabrike Asfalti me QKL në Pronësi / kontratë noteriale qeraje / kontratë noteriale furnizimi.****

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësise, të shoqëruar me leje mjedisore të lëshuar nga QKL si më poshtë:

**QKL - Fabrike asfalti –**

**1.Leje Mjedisore tipi B, Kodi:III.1.B.**

**2.Raport monitorimi nga organe të Akredituara pranë Drejtorise se përgjithshme të Akreditimit ( me afat jo më larg se 6 muaj nga data e publikimit të kontratës).**

**Sqarim:** Për impiantin e asfaltit në pronësi duhet të paraqiten kontrata e blerjes apo zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese, leja mjedisore lëshuar nga QKL fotot, vendodhja e impiantit, karte Teknologjike, për prodhim asfaltobetonit, së bashku me raportin perkatese,

Ne rast te marjes me qera ose kontrate furnizimi kjo kerkese “per impiantin e asfaltit ne pronesi duhet te paraqiten kontrata e blerjes apo zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese, leja mjedisore leshuar nga QKL fotot, vendodhja e impjantit, karte Teknologjike, per prodhim asfaltibetoni, se bashku me raportin perkates.

**Argumentimi:**Ky kriter u vendos ne perputhje me, neni 77, pika 4, ligji nr.162, date 23.12.2021 pasi ben te mundur dhe garanton, perputhshmerine dhe rregullsine e procesit te furnizimit, cilesine e produktit si dhe disponibilitetin te mallit me cilesine e kerkuar, pergjate ekzekutimit te kontrates. Aftësia e operatorëve ekonomikë për të ofruar mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative dhe besueshmërinë për të zbatuar kontratën. neni 77, pika 4, ligji nr.162, date 23.12.2021.Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.Referuar vkm nr.628, datë 15.07.2015 “Për miratimin e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve...specifikimet”, midis të tjerave parashikon se: **përzierja e prodhuar duhet zakonisht të transportohet menjëherë në kantierin e ndërtimit.**

Referuar nenit 2 gërma “b” “qëllimi” i ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se; “qëllimi i këtij ligji është: b) të sigurojë mire përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”. mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Fletë analize ose raport testimi të lëshuar nga organe kompetente shtetërore ose private të akredituara, pergjate realizimit te kontrates ne menyre periodike cdo 60 dite (vetem nga 1(nje) here ne çdo 60 dite te grafikut).

Operatori Ekonomik i cili do te nenshkruaje kontraten, te paraqese flete-analiza te vlefshme te artikujve asfaltobeton binder dhe asfaltobeton tapet.

Flete analizat do te paraqiten sipas grafikut te levrimit te mallit (vetem nga 1(nje) here ne çdo 60 dite te grafikut) nga organe kompetente shtetërore ose private të akredituara.

**Argumentimi:**Ky kriter u vendos ne perputhje me nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/c, të VKM nr. 285, datë19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, ku citohet: ”dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Ne rastin konkret, kemi te bejme me nje kerkese minimale, per nje dokument cilesie per materialet qe autoriteti kontraktor, kerkon te bleje.

Persa me siper kerkohet nje dokument certifikues i cilesise, pra ne perputhje me nenin 77, ligji nr.162, date 23.12.2021. dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknikete kërkuara, qe kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës, sipas zerave te preventivit, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit, pasi jane lehtesisht te siguroeshme, me kosto te ulet, si dhe plotesueshme nga cdo operator qe eshte ne gjendje dhe do te realizoje nje furnizim si ai qe kerkon objekti te kontrates.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata cilësie (të vlefshme) të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akredimit në Shqipëri (DPA), si më poshtë:

- + ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të Cilësisë) ose **ekuivalente të tij**.
- + Çertifikatën ISO 14001-2015 (Sistemi I menaxhimit të mjedisit) ose **ekuivalent**.
- + ISO 45001 Sistemi I menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ose **Ekuivalent**
- + PAS -99 Sistemi I menaxhimit të Integruar ose **Ekuivalent**.

Çertifikata e mesiperme të jete në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj. Çertifikata e mesiperme kërkohet të jete e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili Operator Ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatën ISO 9001-2015, ISO 14001-2015, ISO 45001, PAS -99 sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 1 të nenit 79 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se autoriteti ose enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet objekt prokurimi plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve paraqitjen e certifikatave të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. E njëjta dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike lidhen me kualifikimet e kandidatit apo ofertuesit. Gjithashtu, ky kriter mbështetet në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve paraqitjen e certifikatave të tilla vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit. Ky kriter është vendosur për të garantuar njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë dhe për të vlerësuar aftësinë e tyre teknike dhe profesionale në drejtim të furnizimit me artikuj cilësorë, të prodhuar ose të hedhur në treg sipas standardeve ndërkombëtare.

2.3.6 Sasia e ngarkesës në ditë duhet të jo me pak se 30 Ton Asfaltobeton sipas kërkesave të AK të paraqitura 2 ditë më parë. Kerkesa 2 dite me pare do te paraqitet edhe per artikullin Pramer.

Per realizimin e detyres sipas kerkesave, Operatori Ekonomik duhet te kete ne pronesi ose qera:  
**Kamione**

- a) Jo me pak se 2 cope
- b) Me 4 akse dhe Veteshkarkues

c) Kapacitet jo me pak se 15 ton

Për mjetet që shënohen në regjistrat publikë, kur janë në pronësi duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leje qarkullimi, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit (të vlefshme) dhe certifikata e transportit të mallrave të lëshuar nga bashkia përkatëse. Ndërsa në rastin kur mjetet janë me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet dhe kontrat e qirasë e noterizuar, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo zhdoganimi dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitete dhe kontrat e qirasë e noterizuar, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekti këtij prokurimi.

\*Përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës nr. 9, siç parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Dokumentacioni i përshkruar në këtë pikë do të dorëzohet nga operatori i kualifikuar i pari, kjo në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Operatori ekonomik i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), është përcaktuar ky kriter, me anë të të cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë Autoritetin Kontraktor se disponojnë mjetet e nevojshme të transportit dhe se do të kryejnë shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi në adresat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues. Vendosija e këtij kriteri synon të sigurojë që operatori ekonomik të garantojë shërbimin e transportit në kohë dhe në përputhje me afatet e kontratës, duke pasur parasysh se një pjesë e mallrave do të shpërndahen në shse dhe rruget e Bashkise Durrës.

Kërkesa për të pasur në dispozicion minimumi dy mjete transporti është përcaktuar në mënyrë proporcionale me sasinë e mallrave të kërkuar dhe me vendndodhjen e Autoritetit Kontraktor, ku këto mallra do të depozitohen. Ky kusht garanton sigurinë, vijueshmërinë dhe cilësinë e shërbimit të transportit, duke ulur rrezikun e vonesave ose ndërprerjeve në procesin e furnizimit.

